

Vendim i Gjykatës i datës 11 nëntor 1997. - Hellmut Marschall kundër Land Nordrhein-Westfalen. – Referencë për vendim paraprak: Verwaltungsgericht Gelsenkirchen - Gjermani. – Trajtim i barabartë për burrat dhe gratë – Kandidatë të kualifikuar në mënyrë të barabartë meshkuj dhe femra - Prioritet për kandidatet femra – Klauzola e ruajtjes. - Cështja C-409/95.

Fjalë Kyçe

Politika Sociale – Burrat dhe Gratë - Qasja në punësim dhe kushtet e punës – Trajtim i barabartë - Shmangiet - Masat për promovimin e mundësive të barabarta midis burrave dhe grave - Fushëveprimi - Dispozitë kombëtare e cila i jep përparësi promovimit të grave ndaj burrave ku gratë kanë kualifikime të barabarta dhe janë të nën-përfaqësuar - Klauzolë Ruajtjeje e cila lejon një vlerësim objektiv të secilit rast individual në bazë të kriterëve jo diskriminuese ndaj grave - Nëse është e lëgueshme

(Direktiva e Këshillit 76/207, Nen. 2 (1) dhe (4))

Përmbledhje

Një rregullore kombëtare e cila, në një rast ku ka më pak gra se burra në nivel posti të duhur në një sektor të shërbimit publik dhe kur si kandidatët femra ashtu edhe meshkujt për postin janë njësoj të kualifikuar në aspektin e përshtatshmërisë së tyre, kompetencës dhe performancës profesionale, kërkon që prioritet t'i jepet promovimit të kandidateve femra përveç nëse arsye të veçanta për kandidatin mashkull e cojnë bilancin në favor të tij, nuk pengohet nga Neni 2 (1) dhe (4) i Direktivës 76/207 mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë për sa i përket aksesit në punësim, trajnim dhe promovim profesional dhe kushtet e punës, me kusht që:

- në çdo rast individual rregullorja parashikon për kandidatët meshkuj të cilët janë njësoj të kualifikuar si kandidatet femra garancinë që kandidaturat do të jenë subjekt i një vlerësimi objektiv që do të marrë parasysh të gjitha kriteret e veçanta të kandidatëve dhe do të shkelë prioritetin e akorduar për kandidatet femra ku një ose më shumë nga ato kriteret e cojnë bilancin në favor të kandidatëve meshkuj, dhe

- kriteret e tilla nuk diskriminojnë kandidatet femra.

Palët

Në cështjen C-409/95, të Marrëveshjes së EC nga Verwaltungsgericht Gelsenkirchen (Gjermani) për një vendim paraprak në procedurat në pritje përpara gjykatës ndërmjet

Hellmut Marschall

dhe

Land Nordrhein-Westfalen

mbi interpretimin e Nenit 2(1) dhe (4) Direktivës së Këshillit 76/207/EEC të datës 9 shkurt 1976 mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë lidhur me punësimin, trajnimet dhe promovimet, si dhe kushtet e punës (OJ 1976 L 39, fq. 40),

GJYKATA,

E përbërë nga: G.C. Rodríguez Iglesias, Kryetar, C. Gulmann, H. Ragnemalm dhe M. Wathelet (Kryetarë të Dhomave), G.F. Mancini, J.C. Moitinho de Almeida, P.J.G. Kapteyn (Raporter), J.L. Murray, D.A.O. Edward, J.-P. Puissochet, G. Hirsch, P. Jann dhe L. Sevón, Judges,

Avokat i Përgjithshëm: F.G. Jacobs,

Regjistrues: H.A. Rühl, Administrator Kryesor,

pas marrjes në konsideratë të vërejtjeve të paraqitura me shkrim në emër të:

- Land Nordrhein-Westfalen, përfaqësuar nga Bezirksregierung Arnsberg, nga Juliane Kokott, Profesoreshë në Universitetin Heinrich Heine, Düsseldorf,
- Qeveria Spanjolle, nga Alberto José Navarro González, Drejtor i Përgjithshëm Departamentit të Koordinimit Ligjor dhe Cështjeve të Komunitetit, asistuar nga Gloria Calvo Díaz, Abogado del Estado, e Shërbimit Ligjor Shtetëror, veprues si Agjentë,
- Qeveria Franceze, nga Catherine de Salins, Shefe e Nëndrejtorisë në Drejtorinë Ligjore të Ministrisë së Punëve të Jashtme, dhe Anne de Bourgoing, Shefe Misioni në të njëjtën Drejtori, veprues si Agjentë,
- Qeveria Austriake, nga Wolf Okresek, i Ministrisë në Shërbimin Kushtetues të Zyrës Federale të Kancelarit, veprues si Agjent,
- Qeveria Finlandeze, nga Tuula Pynnä, Konsulent Ligjor në Ministrinë e Jashtme, veprues si Agjent,
 - Qeveria Suedeze, nga Lotty Nordling, Nënsekretar për Cështjet Ligjore të Departamentit të Tregtisë së Jashtme të Ministrisë së Punëve të Jashtme, veprues si Agjent,
 - Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, nga Lindsey Nicoll, i Departamentit të Avokatit të Thesarit, veprues si agjent, dhe nga Eleanor Sharpston, avokat,
 - Qeveria Norvegjeze, nga Beate B. Ekeberg, Shefi i Shërbimit veprues për Ministrinë e Punëve të Jashtme, veprues si Agjent,
 - Komisioni i Komiteteve Europiane, nga Jürgen Grunwald, Konsulent Ligjor, dhe Marie Wolfcarius, i Shërbimit të saj Ligjor, veprues si Agjent;

në lidhje me raportin e Seancës,

pas dëgjimit të vërejtjeve të Land Nordrhein-Westfalen, përfaqësuar nga Juliane Kokott; të Qeverisë Hollandeze, përfaqësuar nga Hans van den Oosterkamp, Konsulent Ligjor i Ministrisë së Punëve të Jashtme, veprues si Agjent; të Qeverisë Finlandeze, përfaqësuar nga Holger Rotkirch, Shefi i Departamentit të Cështjeve Ligjore të Ministrisë së Punëve të Jashtme, veprues si Agjent; të Qeverisë Suedeze, përfaqësuar nga Lotty Nordling; të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, përfaqësuar nga Lindsey Nicoll, Eleanor Sharpston dhe Michael Beloff, QC; dhe të Komisionit, përfaqësuar nga Jürgen Grunwald dhe Marie Wolfcarius, në seancën e datës 11 mars 1997,

pas dëgjimit të Opinioneve të Avokatit të Përgjithshëm në seancën e datës 15 maj 1997,

jep

Vendimin e mëposhtëm

Arësytetime

1 Me urdhër të datës 21 dhjetor 1995, marrë në Gjykatë më 29 dhjetor 1995, Verwaltungsgericht (Gjykata Administrative) Gelsenkirchen iu referua Gjykatës për vendim paraprak sipas Nenit 177 të Marrëveshjes EC, për një çështje mbi interpretimin e Nenit 2(1) dhe (4) të Direktivës së Këshillit 76/207/EEC të datës 9 shkurt 1976 mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë lidhur me aksesin në punësim, kualifikim profesional dhe promovim, si dhe kushtet e punës (OJ 1976 L 39, fq. 40, referuar më tutje si 'Direktiva').

2 Kjo çështje u ngrit në procedurat mes Hellmut Marschall dhe Land Nordrhein-Westfalen (Landi i Veriut të Rhine-Westphalia, në tekstin e mëtutjeshëm 'Landi') në lidhje me kërkesën e tij për një post të klasës më të lartë në Gesamtschule (Shkolla Gjithpërfshirëse) Schwerte në Gjermani.

3 Fjala e dytë e paragrafit 25(5) të Beamtengesetz für das Land Nordrhein-Westfalen (Ligji për Nëpunësit Civilë të Landit), në versionin e publikuar më 1 maj 1981 (GVNW, fq. 234), i ndryshuar sipas Paragrafit 1 të Ligjit të Shtatë i cili bën ndryshime të disa rregulloreve lidhur me shërbimin civil, i datës 5 shkurt 1995 (GVNW, fq. 102, referuar më tutje 'dispozita në fjalë'), parashikon:

"Ku, në sektorin e autoritetit përgjegjës për promovimin, ka më pak gra se burra për atë post karriere, grave duhet t'u jepet prioritet për promovim në rast të përshtatshmërisë së barabartë në aftësi dhe performancë profesionale, përveç nëse arsye të veçanta për kandidatin e caktuar [mashkull] e cojnë bilancin në favor të tij."

4 Në përputhje me vërejtjet e Land-it, rregulli i prioritetit i përcaktuar nga ajo dispozitë paraqiste një kriter shtesë promovimi, atë të të qenurit një femër, si mënyrë për të luftuar pabarazinë që ndikon tek kandidatet femra në krahasim me kandidatët meshkuj që aplikojnë për të njëjtin post: ku kualifikimet janë të barabarta, punëdhënësit kanë tendencën të promovojnë më shumë burrat sesa gratë për shkak se ato zbatojnë kriterin tradicional të promovimit i cili në praktikë, i vendos gratë në një disavantazh, të tillë si mosha, vjetërsia në punë dhe fakti se një kandidat mashkull është kryetari i familjes dhe shtylla ekonomike e saj.

5 Në sigurimin se prioritet do t'i jepet promovimit të grave "përveç nëse arsye të veçanta për kandidatin e caktuar [mashkull] e cojnë bilancin në favor të tij", legjislatura qëllimisht zgjodhi, sipas Land-it, një shprehje ligjërish të papërcaktuar për të siguruar fleksibilitet të mjaftueshëm dhe, në veçanti, për ta lejuar administratën të marrë parasysh çdo arsye e cila mund të jenë specifike për kandidatët individualë. Rrjedhimisht, pavarësisht rregullit të prioritetit, administrata mundet gjithmonë të preferojë një kandidat mashkull mbi bazën e kriterit të promovimit, tradicional ose ndryshe.

6 Në përputhje me urdhrin për referencë, Z. Marschall punon si mësues për Land-in, paga e tij është ajo e shkallës bazë specifikuar sipas karrierës në A 12.

7 Më 8 shkurt 1994 ai aplikoi për promovim në një post A 13 (mësues i kualifikuar për mësimdhënie në një shkollë të mesme të shkallës së parë) në Gesamtschule Schwerte. Bezirksregierung (Autoriteti i Rrethit) Arnsberg e informoi atë, se megjithatë, ai synonte të caktonte një kandidate femër për atë pozicion.

8 Z. Marschall dorëzoi një kundërshtim të cilin Bezirksregierung e refuzoi me vendim më 29 korrik 1994 mbi arësyeshtimin se, sipas dispozitës në fjalë, kandidatja femër duhej të promovohet domosdoshmërisht për pozicionin duek qenë se, në përputhje me vlerësimet e tyre zyrtare të progresit në punë, të dy kandidatët ishin njësoj të kualifikuar dhe duke qenë se në kohën e njoftimit të pozicionit të lirë të punës, kishte më pak femra sesa burra në tabelën e karrierës sipas A 13.

9 Z. Marschall më pas ia paraqiti procedurat ligjore Verwaltungsgericht Gelsenkirchen për marrjen e një urdhri ku ti kërkohet Land-it ta promovonte atë për postin në fjalë.

10 Verwaltungsgericht, pasi gjeti se si Z. Marschall ashtu edhe kandidatja femër të zgjedhur ishin njësoj të kualifikuar për postin, vendosi se rezultati i procedurave varej në përshtatshmërinë e procedurës në fjalë me Nenin 2(1) dhe (4) të Direktivës.

11 Bazuar në gjykimin e kësaj Gjykate në Cështjen C-450/93 Kalanke kundër Freie Hansestadt Bremen [1995] ECR I-3051, Verwaltungsgericht konsideron se prioriteti që dispozita në fjalë akordon në parim për gratë duket të përbëjë diskriminim brenda kuptimit të Nenit 2(1) të Direktivës dhe se një diskriminim i tillë nuk eliminohet nga mundësia e dhënies së preferencës, vecanërisht, për kandidatët meshkuj.

12 Ajo gjykatë gjithashtu dyshon nëse dispozita në fjalë mbulohet nga përjashtimi i parashikuar në Nenin 2(4) të Direktivës lidhur me masat e promovimit të mundësive të barabarta ndërmjet burrave dhe grave. Baza për vlerësimin e kandidatëve është e ngushtë duke qenë se proporcioni numerik i burrave dhe grave në nivelin në fjalë, merret në konsideratë. Për më tepër, the dispozita në fjalë nuk përmirëson aftësinë e grave për të konkurruar në tregun e punës dhe për të ndjekur një karrierë njësoj si burrat por përshkruan një rezultat, ndërsa Neni 2(4) i Direktivës lejon vetëm masat për promovimin e barazisë së mundësive.

13 Verwaltungsgericht prandaj vendosi të pezullojë procedurat dhe ta referojë cështjen në Gjykatë për vendim paraprak:

“A e pengon Neni 2(1) dhe (4) i Direktivës së Këshillit 76/207/EEC të datës 9 shkurt 1976 mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë lidhur me aksesin në punësim, kualifikim profesional dhe promovim, si dhe kushtet e punës, një rregullore të legjislationit kombëtar e cila parashikon se, në sektorë të shërbimit publik, në të cilët më pak gra sesa burra janë të punësuar në poste përkatëse të një shkalle më të lartë karriere, grave duhet t’ju jepet prioritet ku kandidatët meshkuj dhe femra për promovimin janë njësoj të kualifikuar (në terma të përshtatshmërisë, kompetencës dhe performancës profesionale), përveç nëse arësye specifike të një kandidati mashkull e cojnë balancin në favor të tij ("sofern nicht in der Person eines männlichen Mitbewerbers liegende Gründe überwiegen")?”

14 Landi, Qeveritë Spanjolle, Austriake, Finlandeze, Suedeze dhe Norvegjeze si dhe Komisioni konsiderojnë se një rregullore kombëtare e tillë si dispozita në fjalë, përbën një masë për promovimin e barazisë së mundësive ndërmjet burrave dhe grave e cila bie brenda qëllimit të Nenit 2(4) të Direktivës.

15 Landi vëren se prioriteti i dhënë kandidateve femra synon ti kundërpërgjigjet kriterit të promovimit tradicional pa, megjithatë, i zëvendësuar ato. Qeveria Austriake konsideron se një rregullore kombëtare e tillë si ajo në fjalë hartohet për të korrigjuar procedurat diskriminuese në përzgjedhjen e personelit të punës.

16 Qeveritë Finlandeze, Suedeze dhe Norvegjeze shtojnë se rregullorja kombëtare në fjalë promovon aksesin nga gratë në poste me përgjegjësi dhe kështu ndihmon në rregullimin e ekuilibrit në tregjet e punës të cilat, në gjendjen e tyre aktuale janë ende gjerësisht të ndara mbi bazën e gjinisë në atë që ato i vënë kandidatet femra në poste më të ulëta në hierarkinë profesionale. Në përputhje me Qeverinë Finlandeze eksperiencia e kaluar tregon në vecanti se veprimi i kufizuar në ofrimin e trajnimit profesional dhe udhëzimet për gratë ose për influencimin e ndarjes së përgjegjësive

profesionale dhe familjare nuk është i mjaftueshëm për ti dhënë fund kësaj ndarjeje të tregjeve të punës.

17 Së fundi, Landi dhe të gjitha ato qeveri, janë të mendimit se dispozita në fjalë nuk garanton prioritet absolut dhe të pakushtëzuar për gratë dhe se prandaj është brenda kufinjve të nënvizuara nga Gjykata në Kalanke.

18 Qeveria Franceze dhe ajo e Mbretërisë së Bashkuar, konsiderojnë se dispozita në fjalë nuk mbulohet nga derogimi i parashikuar nga Neni 2(4) i Direktivës.

19 Ato dy qeveri paraqesin se në ofrimin e prioritetit që do t'ju jepet grave, dispozita shkon më tej sesa promovimi i barazisë së mundësive dhe synon të sjellë barazinë e përfaqësimit ndërmjet burrave dhe grave kështu që zbatohet arësytimi i Gjykatës në Kalanke.

20 Sipas mendimit të tyre, as prania e klauzolës së kursimit nuk e bën më pak diskriminuese dispozitën në fjalë. Ajo klauzolë zbatohet vetëm përjashtimisht dhe prandaj nuk ndikon në rastin "normal" ku nuk ka arsye specifike për kandidatin mashkull të cilat janë të tilla që të ia kalojnë kërkesës së përgjithshme për caktimin e kandidatës femër. Duke qenë se, për më tepër, formulohet në terma të cilat janë si të përgjithshme ashtu edhe jo precize, klauzola është në kundërshtim parimin e sigurisë ligjore.

21 Gjykata vëren se qëllimi i Direktivës, sic bëhet i qartë nga Neni 1(1), është bërja efektive në Shtetet Anëtare, e parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë ndër të tjera, qasjen në punësim, duke përfshirë promovimin. Neni 2 (1) thekson se parimi i trajtimit të barabartë do të thotë se 'nuk do të ketë diskriminim çfarëdo qoftë në baza të gjinisë ose direkt ose indirekt'.

22 Sipas nenit 2 (4), Direktiva është krijuar, pa paragjykim, për masat për promovimin e mundësive të barabarta për burrat dhe gratë, në veçanti duke hequr pabarazitë ekzistuese të cilat ndikojnë në mundësitë e grave në fushat e përmendura në nenin 1 (1) '.

23 Në paragrafin 16 të gjykimit të saj në Kalanke, Gjykata u shpreh se një rregull kombëtar i cili parashikon se gratë duhet automatikisht të kenë prioritet atëherë kur burrat dhe gratë e kualifikuar në mënyrë të barabartë, janë kandidatë për të njëjtin promovim, në fushat ku ka më pak gra se burra në nivelin e postit përkatës, përfshin diskriminim për shkak të gjinisë.

24 Megjithatë, ndryshe nga dispozitat në fjalë në Kalanke, dispozita në fjalë në këtë rast përmban një klauzolë ('Öffnungsklausel', në tekstin "klauzolë e ruajtjes") për efektin se grave nuk duhet t'u jepet përparësi në promovim nëse arsye të veçanta për një individ, kandidat mashkull, e cojnë bilancin në favor të tij.

25 Prandaj është e nevojshme marrja në konsideratë nëse një rregull kombëtar që përmban një klauzolë të tillë është projektuar për të nxitur barazinë e mundësive mes burrave dhe grave në kuadër të kuptimit të nenit 2 (4) të Direktivës.

26 Neni 2 (4) është hartuar në mënyrë specifike dhe ekskluzivisht për të autorizuar masat të cilat, edhe pse diskriminuese në dukje, në të vërtetë kanë për qëllim eliminimin ose zvogëlimin e rasteve aktuale të pabarazisë të cilat mund të ekzistojnë në realitetin e jetës shoqërore (Rasti 312/86 Komisionit kundër Francës [1988] ECR 6315, paragrafi 15, dhe Kalanke, paragrafi 18).

27 Pra autorizon masat kombëtare të cilat kanë të bëjnë me qasjen në punësim, duke përfshirë promovimin, që i japin një avantazh të veçantë grave me qëllim përmirësimin e aftësive të tyre për të konkurruar në tregun e punës dhe për të ndjekur një karrierë në mënyrë të barabartë me meshkujt (Kalanke, paragrafi 19).

28 Ashtu sic Këshilli theksoi në recitalin e tretë në preambulën e Rekomandimit 84/635/EEC të 13 dhjetorit 1984 mbi promovimin e veprimit pozitiv për gratë (OJ L 331 1984, fq. 34), dispozitat ekzistuese ligjore për trajtimin e barabartë, të hartuara për të përballuar të drejtat e individëve, janë të pamjaftueshme për eliminimin e të gjitha pabarazive ekzistuese derisa veprim paralel të merret nga qeveritë, të dy anët e industrisë dhe të organeve të tjera të interesuara, për të luftuar efektet paragjyquese ndaj grave në punësim të cilat lindin nga qëndrimet shoqërore, sjellja dhe strukturat (Kalanke, paragrafi 20).

29 Ashtu sikurse Land-i dhe disa qeveri kanë vënë në dukje, duket se edhe aty ku kandidatët meshkuj dhe femra janë njësoj të kualifikuar, kandidatët meshkuj kanë tendencë të preferohen më tepër se kandidatet femra në veçanti për shkak të paragjyqimeve dhe stereotipeve lidhur me rolin, kapacitetet dhe frikën e grave në jetën e punës, për shembull, faktit që gratë e ndërpresin karrierën e tyre më shpesh, që për shkak të detyrimeve shtëpiake dhe familjare ato do të jenë më pak fleksibël në orët e tyre të punës, ose se ato do të mungojnë në punë më shpesh për shkak të shtatzënisë, lindjes dhe ushqyerjes me gji.

30 Për këto arsye, fakti i thjeshtë që një kandidat mashkull dhe një kandidate femër janë njësoj të kualifikuar nuk do të thotë se ata kanë të njëjtat shanse.

31 Një rregull kombëtar në aspektin e të cilës, në përputhje me zbatimin e klauzolës së ruajtjes, kandidatet femra për promovim, të cilat janë të kualifikuara në mënyrë të barabartë si meshkujt, do të kenë përparësi në sektorët ku ato janë të nën-përfaqësuar, mund të bie brenda shtrirjes së nenit 2 (4) në qoftë se një rregull i tillë mund të luftojë efektet paragjyquese për kandidatet femra të qëndrimeve dhe sjelljeve të përshkruara më lartë dhe kështu të reduktojë rastet aktuale të pabarazisë të cilat mund të ekzistojnë në botën reale.

32 Megjithatë, duke qenë se Neni 2 (4) përbën një shmangie nga një e drejtë individuale e përcaktuar nga Direktiva, një masë e tillë kombëtare, e cila në mënyrë specifike favorizon kandidatet femra, nuk mund të garantojë prioritet absolut dhe të pakushtëzuar për gratë në rast të një promovimi pa shkuar përtej kufijve të përjashtimit të paraparë në atë dispozitë (Kalanke, paragrafët 21 dhe 22).

33 Ndryshe nga rregullat në fjalë në Kalanke, një rregull kombëtare e cila, si në rastin në fjalë gjatë procedurave kryesore, përmban një klauzolë ruajtjeje, nuk i kalon këto kufij në qoftë se, në çdo rast individual, ajo ofron për kandidatët meshkuj të cilët janë të kualifikuar njësoj si kandidatet femra, garancinë se kandidaturat do të jenë subjekt i një vlerësimi objektiv i cili do të marrë parasysh të gjitha kriteret specifike për kandidatët individualë dhe do të shkelë prioritetin e akorduar për kandidatet femra ku një ose më shumë nga ato kriteret e cojnë bilancin në favor të kandidatit mashkull. Në këtë drejtim, megjithatë, duhet të mbahet mend se këto kriteret nuk duhet të jenë të tilla që të diskriminojnë kandidatet femra.

34 I takon gjykatës kombëtare të përcaktojë nëse ato kushte plotësohen në bazë të shqyrtimit të qëllimit të dispozitës në fjalë siç është zbatuar nga Land-i.

35 Përgjigja që i duhet dhënë gjykatës kombëtare, duhet pra të jetë, që një rregull kombëtare e cila, në rastet ku ka më pak gra se burra në nivel të postit përkatës në një sektor të shërbimit publik, dhe të dy kandidatët si femrat dhe meshkujt për postin janë po aq të kualifikuar në aspektin e përshtatshmërisë së tyre, kompetencës dhe performancës profesionale, kërkon që prioritet t'i jepet promovimit të kandidateve femra nëse arsye të veçanta për kandidatin e caktuar mashkull të cilat e cojnë bilancin në favor të tij nuk pengohen nga Neni 2 (1) dhe (4) i Direktivës, me kusht që:

- në çdo rast individual, rregulli të parashikojë për kandidatët meshkuj të cilët janë të kualifikuar njësoj si kandidatet femra, garancinë se kandidaturat do të jenë subjekt i një vlerësimi objektiv i cili do të marrë parasysh të gjitha kriteret specifike për kandidatët individualë dhe do të shkelë prioritetin e akorduar për kandidatet femra ku një ose më shumë nga ato kritere e cojnë bilancin në favor të kandidatit mashkull.

- këto kritere nuk duhet të jenë të tilla që të diskriminojnë kandidatet femra.

Vendimi mbi Shpenzimet

Shpenzimet

36 Shpenzimet e bëra nga Qeveritë Spanjolle, Franceze, Hollandeze, Austriake, Finlandeze, Suedeze, të Mbretërisë së Bashkuar dhe Norvegjezi dhe nga Komisioni i Komuniteteve Evropiane, të cilat kanë paraqitur vërejtje në Gjykatë, nuk janë të rikuperueshme. Duke qenë se këto procedura janë, për palët në procedurën kryesore, një hap në procedurën në pritje pranë gjykatës kombëtare, vendimi për shpenzimet i takon asaj gjykate.

Pjesa operative

Mbi ato arësytetime,

GJYKATA,

në përgjigje të pyetjes referuar asaj nga Verwaltungsgericht Gelsenkirchen me urdhër të 21 dhjetorit 1995, me anë të kësaj rregullat:

Një rregull kombëtare e cila, në rastet ku ka më pak gra se burra në nivel të postit përkatës në një sektor të shërbimit publik, dhe të dy kandidatët si femrat dhe meshkujt për postin janë po aq të kualifikuar në aspektin e përshtatshmërisë së tyre, kompetencës dhe performancës profesionale, kërkon që prioritet t'i jepet promovimit të kandidateve femra nëse arsye të veçanta për kandidatin e caktuar mashkull të cilat e cojnë bilancin në favor të tij nuk pengohen nga Neni 2 (1) dhe (4) i Direktivës së Këshillit 76/207/KES të datës 9 shkurt 1976, për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë për sa i përket qasjes në punësim, trajnim dhe promovim profesional dhe kushtet e punës, me kusht që:

- në çdo rast individual, rregulli të parashikojë për kandidatët meshkuj të cilët janë të kualifikuar njësoj si kandidatet femra, garancinë se kandidaturat do të jenë subjekt i një vlerësimi objektiv i cili do të marrë parasysh të gjitha kriteret specifike për kandidatët individualë dhe do të shkelë prioritetin e akorduar për kandidatet femra ku një ose më shumë nga ato kritere e cojnë bilancin në favor të kandidatit mashkull.

- këto kritere nuk duhet të jenë të tilla që të diskriminojnë kandidatet femra.